



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.07.2023, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik "ASFALT GROUP" SH.P.K; Gurëbardhi SH.P.K; Benita Company; Dreoni SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Rrugës X", Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi i Operatorëve ekonomik "ASFALT GROUP" SH.P.K; Gurëbardhi SH.P.K; Benita Company; Dreoni SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Rrugës X", Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003-511, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 24.07.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 24.07.2023;

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.28.07.2023, Grupi Operatorëve ekonomik "ASFALT GROUP" SH.P.K; Gurëbardhi SH.P.K;; Benita Company; Dreoni SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Rrugës X", Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.08.2023, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj në lidhje me eliminimin e ofertës tuaj është i pabazuar, sepse lista e kontratave e parqitur nga ju nuk e përmbush kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT-ë (lideri duhet të ketë 60% të vlerës së qarkullimit).

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar

Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm

69

Pretendimi juaj i parë lidhur me damperët, gjithashtu është i pabazuar sepse me sqarimet shtesë të ofruara nga Operatori ekonomik fitues kanë qenë të mjaftueshme dhe bindëse për Autoritetin Kontraktues.

Pretendimi juaj i dytë lidhur me ngarkuesit, është i pabazuar sepse në dudin doganor shënon se është 32 ton dhe këtë Autoriteti kontraktues e merr si të mirëqenë.

Pretendimi juaj i tretë lidhur me lugët hidraulike, gjithashtu është i pabazuar sepse me sqarimet shtesë të kofruara nga Operatori ekonomik fitues kanë qenë të mjaftueshme dhe bindëse për Autoritetin Kontraktues.

Pretendimi juaj i katërt nuk qëndron pasi që koncesionari PEVLAKU shpk, ka prezantuar marrëveshje me Alesio shpk për marrje me qera të autobetonierkave – mikserëve.

Pretendimi juaj i pestë, nuk qëndron pasi që koncesionari PEVLAKU shpk, ka prezantuar marrëveshje me Alesio shpk për marrje me qera të kamionit spërkatës për bitum dhe emulzion.

Pretendimi juaj i gjashtë, nuk qëndron pasi që është prezantuar dëshmi për buldozer min 25t.

Pretendimi juaj i shtatë, i tetë dhe i nëntë nuk qëndron pasi që GOE ka dorëzuar certifikimet në përputhje me kërkesën në pikën 9.1&9.2 të DT-ës.

Pretendimi i juaj i dhjetë për deklaratën e anëtarëve të konsorciumit nuk qëndron pasi që një deklaratë e konsorciumit të GOE është dorëzuar bashkë me ofertë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

**Faton Gutaj**  
  
**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës